



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

E lidhur në Tiranë, sot, më datë 15.10.15, mes palëve:

1. Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me adresë Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari, z. Gentian Sala, që këtu e më poshtë “AMA”

dhe

2. Shoqatës “Këshilli i Medias”, me adresë “Rr. Frederik Shiroka”, Kulla 3, Shkalla 3, Kati 2, Zyra 3, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i saj, z. Koloreto Cukali që këtu e më poshtë “Këshilli”.

Meqenëse:

-AMA, është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

-Këshilli i Medias ka për qëllim nxitjen e respektimit të Kodit të Etikës së Medias nga organizatat e shtypit, medias audiovizive dhe atyre të internetit në vend;

-AMA, gjatë ushtrimit të detyrave të veta funksionale, krijon, mbledh, përpunon, administron, ruan dhe shërben pasuri dokumentare arkivore;

-Këshilli i Medias ka për qëllim përfaqësimin e interesit qytetar në raport me rastet e shkeljes së etikës në raportimet e medias shqiptare;

Palët, me vullnetin e tyre të lirë, të pacenuar, lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi (“Marrëveshja”) si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshje është (i) shfrytëzimi, pa pagesë, i arkivit të AMA-s nga Këshilli i Medias, në funksion të njohjes së veprimtarisë së AMA-s dhe për qëllime studimore dhe të kërkimit shkencor, (ii) shkëmbimi i informacionit dhe të publikimeve mes palëve, si dhe (iii) bashkëpunimi për organizimin e trajnimeve të personelit të AMA-s, për çështje të etikës, vlerësimit dhe analizës së përmbajtjeve të transmetuara, etj.

## **Neni 2**

### **Arkivi i shfrytëzueshëm**

Arkivi i shfrytëzueshëm sipas kësaj Marrëveshje, do të jetë tërësia e dokumenteve të krijuara, mbledhura, përpunuara, administruara, gjatë veprimtarisë së AMA-s, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre, me vlerë historike kombëtare juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore, me përjashtim të atyre të mbrojtura me akte normative të veçanta.

## **Neni 3**

### **Shkëmbi i informacionit**

Palët do të shkëmbejnë çdolloj informacioni dhe/ose publikimi që mendojnë se është në dhe për interes të tyre, në funksion të qëllimit për të cilin kanë lidhur këtë marrëveshje.

Përjashtim nga paragrafi i parë i këtij neni bëjnë ato lloj informacionesh që janë të mbrojtura me ligj dhe që nuk mund të shkëmbehen.

## **Neni 4**

### **Trajnimi i personelit të AMA-s**

Këshilli merr përsipër të kryejë trajnime të personelit të AMA-s për çështje të etikës, vlerësimit dhe analizës së përmbajtjeve të transmetuara, etj. Personeli që do të marrë pjesë në trajnim zgjidhet nga Kryetari i AMA-s. Vendi, ora dhe modulet e trajnimeve përcaktohen në dakordësi nga të dyja palët.

## **Neni 5**

### **Afati**

Kjo marrëveshje lidhet me një afat prej 4 (katër) vjetësh, i cili fillon nga data e nënshkrimit të saj prej palëve.

## **Neni 6**

### **Shfrytëzuesit e arkivit**

Arkivi do të shfrytëzohet nga anëtarët e Këshillit apo persona të autorizuar nga Kryetari i shoqatës Këshilli i Medias.

## **Neni 7**

### **Mënyra e shfrytëzimit**

Personat, sipas nenit 6, që të mund të shfrytëzojnë arkivin e AMA-s, duhet të jenë të pajisur me:

- Vërtetim ose autorizim të nënshkruar nga Kryetari i shoqatës Këshilli i Medias;
- Kopje të kartës së identitetit;
- Kërkesë për qëllimin e shfrytëzimit të arkivit, e cila, duhet të tregojë edhe afatin për të cilin kërkohet shfrytëzimi i arkivit, natyrën e dokumentacionit që kërkohet, etj.

AMA shqyrton kërkesën brenda një afati të arsyeshëm dhe, në rast se e pranon atë, përcakton ditët dhe oraret gjatë të cilave do të mund të bëhet shfrytëzimi i arkivit.

Përpara fillimit të shfrytëzimit të arkivit, personi sipas pikës 6 të kësaj Marrëveshje do të nënshkruajë edhe një deklaratë për përdorimin me korrektësi të arkivit, sipas qëllimit të paracaktuar, duke marrë përsipër edhe angazhimin se do të respektojë parimin e mirëbesimit në lidhje me çdo informacion sensitiv, apo të mbrojtur me ligj, me të cilin mund të përballet, gjatë shfrytëzimit të arkivit.

## **Neni 8**

### **Vendi i shfrytëzimit**

Shfrytëzimi i arkivit do të bëhet vetëm në mjediset e AMA-s. Marrja e kopjeve të dokumenteve lejohet vetëm me leje të Kryetarit të AMA-s, ose personit të autorizuar prej tij.

## **Neni 9**

### **Mirëbesimi**

Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.

Secila prej palëve është e detyruar të mbajë dhe ruajë konfidencialitetin për çdo informacion mbi/ose në lidhje me palën tjetër dhe që është i lidhur me objektin e kësaj marrëveshje dhe, pa aprovimin paraprak me shkrim nga ana e palës tjetër, ajo nuk do të përdorë, publikojë, kopjojë, riprodhojë, transmetojë, transferojë të tretëve asnjë informacion konfidencial për asnjë lloj qëllimi.

## **Neni 10**

### **Rinovimi/përfundimi**

Kjo Marrëveshje rinovohet automatikisht, me të njëjtat kushte, në rast se asnjëra prej palëve nuk është shprehur për mosrinovimin e saj të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.

## **Neni 11**

### **Marrëveshja**

Kjo Marrëveshje përbën të vetmen marrëveshje midis Palëve në lidhje me objektin e saj.

Çdo shtesë a ndryshim i saj do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të fillojë efekte juridike vetëm pas nënshkrimit nga palët.

## Neni 12

### Juridiksioni

Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 13

### Të fundit

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje me fuqi të njëjtë ligjore, nga të cilat njëra qëndron pranë AMA-s dhe tjetra pranë Këshillit.

Palët lexojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje, duke pranuar kështu kushtet saj, në dhe për interes të qëllimeve që përfaqësojnë.

Në dhe për interes të AMA-s.

  
\_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

Në dhe për interes të Këshillit.

  
\_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_ / \_\_\_ / 2015 .

